

Udhëzim i Përkohshëm I_02_2006 mbi Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore

Shtojca Nr. 2

Shabllon për raportin rregullativ të auditorit

[Shëno datën e raportit]

Kryesuesit të Bordit, Zyra e Rregullatorit për Energji

Pasqyrat (Deklaratat) rregullative për periudhën e përfunduar më [shëno periudhën dhe datën]

Ne kemi audituar Pasqyrat Rregullative dorëzuar nga [shëno emrin e të licencuarit – ndërmarrja e ngrohjes qendrore] bashkë me këtë Raport Rregullativ. Këto paraqesin një raport financiar me qëllim të veçantë, i cili kërkohet të përgatitet në përputhje me kushtin [shëno numrin] të Licencës mbajtur nga i Licencuari dhe nxjerrë nga Zyra e Rregullatorit për Energji (“Zyra”).

Përgjegjësitë përkatëse të Drejtorëve dhe auditorëve

Drejtorët e Ndërmarrjes së Ngrohjes Qendrore janë përgjegjës për përgatitjen e Pasqyrave Rregullative. Është përgjegjësi e jona, të krijojmë një opinion të pavarur, bazuar në revizionin tonë, në ato llogari, dhe të raportojmë opinionin tonë tek ju.

Ky raport është përgatitur vetëm për qëllime të përmbushjes së kërkesave të Zyrës, siç është dhënë në Udhëzimet e Raportimit Rregullativ nxjerrë nga Zyra. Është i përgatitur vetëm për nevojat e Zyrës dhe ndërmarrjes së ngrohjes qendrore dhe nuk është për përdorim për qëllime tjera nga ato të specifikuar në këtë dokument. Ne nuk pranojmë asnjë supozim rreth përgjegjësisë për besimin (sigurinë) në këtë raport, apo në Pasqyrat Rregullative, nga cilido person për çfarëdo qëllimi tjetër nga ato dhe nga kush është përgatitur.

Bazat e opinionit

Ne kemi udhëhequr auditimin tonë në përputhje me Standardet Kosovare të Auditimit. Një auditim përfshin ekzaminimin, në baza testimi, ekzaminimin e dëshmive përkatëse për shumën dhe hapjen e tyre në pasqyrat (deklaratat) financiare të rregullatorit. Ai gjithashtu përfshin një vlerësim të shifrave dhe gjykimeve domethënëse që janë bërë prej Drejtorëve gjatë përgatitjes së Pasqyrave Rregullative, si dhe nëse politikat e aplikuar të kontabilitetit janë të përshtatshme për rethanat e ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore, të aplikuar here pas here dhe të hapura siç duhet.

Ne kemi lexuar informatën tjetër që është përfshirë në Raportin Vjetor dhe deklaratat financiare të të Licencuarit dhe kemi shqyrtuar përfshirjet e ndonjë deklarate të gabuar ose mospërpunueshmërisë së dukshme të materialeve që mund të jenë midis këtyre Paraqitjeve rregullative dhe paraqitjeve financiare statutores të ndërmarrjes së ngrohjes qendrore.

Opinion

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Rregullative dhe informatat tjera përmbajnë informacione për periudhën e përfunduar [*shëno datën e përfundimit të periudhës*] që i nevojitet të Licencuarit – ndërmarrje e ngrohjes qendrore – të përgatisë dhe t’ju dorëzojë juve, në mënyrë që të jetë në përputhje me kushtin [*shëno numrin*] të Licencës që bartet nga I Licencuari.

Në lidhje me këtë informatë, ne raportojmë se sipas mendimit tonë:

- a) Regjistrat e duhur të kontabilitetit janë / nuk janë [*fshijeni atë që ju duket e përshtatshme*] mbajtur nga i Licencuari – ndërmarrja e ngrohjes qendrore.
- b) Informata është/nuk është [*fshijeni atë që ju duket e përshtatshme*] në pajtim me të dhënat e kontabilitetit të ndërmarrjes së ngrohjes qendrore dhe është/ nuk është [*fshijeni atë që ju duket e përshtatshme*] e përgatitur si duhet dhe në përputhje me Udhëzimet mbi Raportin Rregullativ të nxjerrë nga Zyra.
- c) Llogaritë Rregullative japin [*sipas kualifikimeve të renditura më poshtë*] një shqyrtim të vërtetë dhe të drejtë të të ardhurave, kostove, asetëve dhe borxheve të të Licencuarit – ndërmarrjes së ngrohjes qendrore dhe atë në përputhje me parimet dhe politikat e kontabilitetit, të përcaktuara në Udhëzimet mbi Raportimin Rregullativ.

[Nëse auditori nuk mundet të japë një opinion të kualifikuar, atëherë duhet të jepet një deklaratë ku renditen karakteristikat e regjistrave të kontabilitetit, pajtimi mes regjistrave të kontabilitetit dhe Pasqyrave (Deklaratave) Rregullative dhe në baza të përgatitjes së Pasqyrave Rregullative, si dhe çdo çështje tjetër që mund të krijojë ndonjë dallim të madh midis Pasqyra Rregullative dhe një shqyrtimi të drejtë dhe të vërtetë të të Licencuarit – pozitës financiare të ndërmarrjes së ngrohjes qendrore]

I juaji sinqerisht,

[*shëno emrin e auditorit*]

[*shëno emrin e nënshkruesit*]